

# INCIDENTET POTENCIALISHT ETNIKISHT TË MOTIVUARA: SFIDAT NË PËRKUFIZIM DHE RAPORTIM



**Autorë: Helena W. Nilsson dhe Rachele Olinger**  
**Redaktorë: Adrian Zeqiri dhe Pieter Troch**

### **Falënderim**

ECMI Kosova dëshiron të falënderojë zyrtarët nga Departamenti i Statistikave në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Policinë e Kosovës, Zyrën e Prokurorit të Shtetit, EULEX-in, OSBE-në dhe Programin Ndërkombëtar të Asistencës për Trajnime në Hetimet Kriminale i cili ka dhënë informacion dhe të dhëna të çmuara për këtë raport.

### **ECMI Kosova [www.ecmikosovo.org](http://www.ecmikosovo.org)**

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumetnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëvepruar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

Rruga Nëna Terezë Nr. 20, Banesa 5,  
10000 Prishtinë – Kosovë,  
Tel. +381 (0) 38 224 473

Rruga Čika Jovina Nr. 3, Kati i I-rë,  
38220 Mitrovicë Veriore – Kosovë,  
Tel. +381 (0) 64 00 55 488

### **Klauzole e përgjegjësisë**

Ky publikim është bërë me mbështetje të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e ECMI Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

### **E drejta autoriale**

© Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) Kosova, gusht 2016. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo lloj mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, incizimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të ECMI Kosovës.

# **INCIDENTET POTENCIALISHT ETNIKISHT TË MOTIVUARA: SFIDAT NË PËRKUFIZIM DHE RAPORTIM**





## **TABELA E PËRMBAJTJES**

<b>LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE.....</b>	<b>6</b>
<b>1. HYRJE.....</b>	<b>7</b>
<b>2. METODOLOGJIA.....</b>	<b>9</b>
<b>3. PËRKUFIZIMI I INCIDENTEVE ETNIKISHT TË MOTIVUARA.....</b>	<b>10</b>
3.1 Vërejtje të përgjithshme mbi përkufizimin e incidenteve etnikisht të motivuara dhe krimeve të urrejtjes.....	10
3.2 Korniza ligjore.....	11
3.3 Struktura përkatëse institucionale: Policia e Kosovës, Prokuroria dhe Gjyqësori.....	12
<b>4. SFIDAT QË LIDHEN ME PËRKUFIZIMIN DHE RAPORTIMIN E INCIDENTEVE ETNIKISHT TË MOTIVUARA.....</b>	<b>14</b>
4.1. Mungesa e mbledhjes, analizimit, dhe shpërndarjes së të dhënave .....	14
4.2. Procedurat e raportimit të Policisë së Kosovës për incidentet potencialisht etnikisht të motivuara.....	14
4.3. Klasifikimi dhe mbledhja e të dhënave nga Zyra e Prokurorisë së Shtetit për incidentet potencialisht etnikisht motivuara.....	16
4.4 Praktikë gjyqësore dhe Mbledhja e të dhënave.....	17
4.5 Monitorimi i incidenteve të mundshme etnikisht të motivuara nga OSBE-ja dhe EULEX-i..	18
4.6 Studimet e rasteve.....	19
4.7 Mungesa e besimit dhe njohurive të qytetarëve për sa i përket mekanizmave të drejtësisë..	20
<b>5. RAPORTIMI I MEDIAVE DHE DEGËZIMET/PASOJAT POLITIKE.....</b>	<b>22</b>
<b>6. VËREJTJET PËRFUNDIMTARE.....</b>	<b>24</b>
<b>7. REKOMANDIMET.....</b>	<b>25</b>
7.1 Përkufizimi dhe Raportimi.....	25
7.2 Rritja e mbledhjes, analizimit dhe shpërndarjes së të dhënave .....	25
7.3 Ndjekja penale dhe gjykimi i IPEM-ve .....	26
7.4 Forcimi i lidhjeve me pjesëtarët e komuniteteve.....	26
<b>8. REFERENCAT.....</b>	<b>27</b>

## **LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE**

---

<b>ECMI Kosova</b>	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë
<b>EVSB</b>	Ekipi i Veprimit për Siguri në Bashkësi
<b>EULEX</b>	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit
<b>ICITAP</b>	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnime në Hetimet Kriminale
<b>IPEM</b>	Incidentet potencialisht etnikisht të motivuara
<b>KFOR</b>	Forca e Kosovës
<b>KPP</b>	Kodi i Procedurës Penale
<b>KP</b>	Kodi Penal
<b>KKSM</b>	Këshilli Komunal për Siguri në Komunitet
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PK</b>	Policia e Kosovës

## 1. HYRJE

Duke qenë një shoqëri shumetnike, është e një rëndësie të madhe që Kosova të promovojë dhe mbrojë marrëdhëniet e qëndrueshme ndëretnike. Edhe pse incidente ndëretnike nuk janë problem ekskluziv apo i veçantë i Kosovës, megjithatë këto incidente përbëjnë një kërcënim të posaçëm për stabilitetin dhe sigurinë në vend. The Paqëndrueshmëria aktuale politike në Kosovë, dhe të kujtuarit e konfliktit të dhunshëm të viteve 1990 dhe fillimit të viteve 2000, dhe pozita e cenueshme e komuniteteve pakicë, krijojnë një aso situatë të bën që incidentet e mundshme me motive etnike (IPEM) të kenë një peshë dhe/apo rëndësi të veçantë; nganjëherë incidente të tilla kanë pasojë të gjera për stabilitetin e Kosovës dhe janë të prira për të qenë të politizuara. Kjo vlen sidomos për incidentet që ndodhin në mes të komunitetit shqiptarë dhe atij serb.

Një shembull se si IPEM-ët mund të dërgojnë në një përshkallëzim të dhunshëm në vija etnike janë trazirat e marsit të vitit 2004. Pas një incidenti kur dy djem shqiptarë u mbytën pasi që thuhet se kishin qenë të ndjekur nga disa serbë, serbët dhe pronat e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës u sulmuan nga turma të zemëruara të rinisë shqiptare dhe situata gjithandej Kosovës shpërtheu dhe u përshkallëzua shumë shpejt. Edhe pse incidenti në fjalë ishte drejtpërsëdrejti një IPEM, trazirat ishin edhe rezultat i frustrimit të gjerë të publikut me skenën e përgjithshme politike dhe në përgjithësi me situatën në ngecje nën administrimin e UNMIK-ut, tregojnë qartë se trazirat dhe incidentet me përshkallëzim ndëretnik mund të dalin apo evoluojnë nga nevoja e qytetarëve për të ngritur zërin dhe deklaruar frustrim e tyre me gjendjen e përgjithshme socio-ekonomike.

Shumica e incidenteve janë pasojë e ngjarjeve apo ndodhive banale ndëretnike që ndodhin në politikë apo ngjarje sportive, dhe do të intensifikohet përmes një efekti të ndjeshëm me një frustrim të madh socio-ekonomik dhe politik. Janë evidentuar për shembull një numër i rasteve të incidenteve të raportuara në Kosovë pas ndeshjes kualifikuese, për kampionatin evropian të futbollit në Francë, në vitin 2014 në mes të Shqipërisë dhe Serbisë. Kjo lojë ishte anuluar për shkak të përlëshjeve fizike mes lojtarëve dhe personelit të dy ekipeve, pasi që ishte lëshuar një fluturake mbi fushë dhe që mbante një banderolëe cila i referohej Shqipërisë së Madhe.

Duke reflektuar politizimin dhe ndjeshmërinë e kësaj çështjeje, incidentet ndëretnike dhe çështjet e sigurisë në Kosovë, dhe veçanërisht ato që përfshijnë komunitetin serb, janë ndjekur nga afër nga komuniteti ndërkombëtar. Raporti i Progresit i vitit 2015 i Komisionit Evropian theksoi se: "Ndërsa situata e përgjithshme e sigurisë për komunitetet jo-shumicë mbetet relativisht e qëndrueshme, një trend në rritje i incidenteve ndëretnike kanë ndodhur që në shënjestër kanë pasur pjesëtarët e komunitetit serb që jeton në Kosovën perëndimore, incidente që kanë përfshirë vjedhje të shpeshta të shtëpive duke shkakuar kështu edhe një ndjenjë të pasigurisë brenda komunitetit të prekur. Autoritetet e Policisë dhe të Gjyqësorit të Kosovës duhet të kuptojnë më mirë se çfarë në fakt përbën një incident etnikisht i motivuar." <sup>1</sup>

Siguria e komunitetit dhe incidentet ndëretnike janë gjithashtu një segment i përhershëm i përfshirë në Raportin Tremujor të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi Misionin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

<sup>1</sup> KOMISIONI EVROPIAN. Kosovo\* 2015 Raporti i Progresit (2016), fq.26;

Raporti i janarit të vitit 2015 përmend "një trend në rritje të numrit të incidenteve potencialisht etnikisht të motivuara",<sup>2</sup> duke iu referuar incidentit kur një autobus, me persona të zhvendosur serbë, në rrugëpër të marrë pjesë në festën e Krishtlindjeve ortodokse në Kishën ortodokse në Gjakovë ishte goditur me një gur.<sup>3</sup>

Raportimi dhe monitorimi i këtyre incidenteve nga mekanizmat dhe komuniteti ndërkombëtar është i rëndësishëm për shkak të implikimeve që këto incidente mund të kenë për sigurinë e përgjithshme në Kosovë dhe janë gjithashtu një tregues i përparimit të Kosovës në integrimin e komuniteteve të ndryshme etnike. Ky mekanizëm i raportimit megjithatë ngre shqetësimin se institucionet dhe politikanët e Kosovës mund të përmbahen duke mos i klasifikuar këto incidente si krime ndëretnike apo të urrejtjes nga frika se këto incidente mandej do të përmenden në raportin tremujor në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Perceptimi mbarë popullorë për sa i përket sigurisë dhe shpeshtësia e incidenteve ndëretnike si dhe roli i medieve dhe politikanëve në raportimin e këtyre incidenteve janë shumë të rëndësishme dhe duhet marrë parasysh. Perceptimi i thjeshtë dhe/ose prezantimi në media i një incidenti si incident me motive etnike mund të nxisë dhunë reale potencialisht etnikisht të motivuar. Mediet kryesore dhe politikanët shqiptarë të Kosovës kanë nxjerrë mësim të rëndësishëm nga trazirat e marsit të vitit 2004 dhe janë shumë të kujdesshëm kur raportojnë për incidentet që përfshijnë pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme dhe përpiqen të pakësojnë apo minimizojnë elementet ndëretnike të incidenteve, nga frika e përshkallëzimit apo politizimit të situatës. Në të kundërtën, mediet serbe kanë tendencë që kryesisht të fokusohen në elementin ndëretnik në një incident eventual, që nganjëherë mund të fus/rrënjosë një frikë të vërtetë apo të perceptuar në mesin e disa komuniteteve, veçanërisht të komunitetit serb. Rritja e vazhdueshme e medieve sociale e bën procesin e raportimit edhe më të vështirë për të kontrolluar.

Raportimi i Policisë dhe ndjekja e mëtejme penale luajnë një rol veçanërisht të rëndësishëm në trajtimin e rasteve të incidenteve potencialisht etnikisht të motivuara, meqë Policia jep apo ofron llogari faktike jo spekulative mbi incidentet dhe natyrën e tyre, që mund të zvogëlojë në masë drastike potencialin apo mundësinë për politizim dhe përshkallëzim të situatës. Për më tepër, të raportuarit e drejtë dhe procesi i hetimit profesionalë nga autoriteti i Policisë së Kosovës mund të ndihmojë në forcimin e sigurisë dhe nivelin e besueshmërisë së pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në institucionet e Republikës së Kosovës. Megjithatë, ekziston rreziku i një mospërputhje në mes të perceptimeve të pjesëtarëve të komuniteteve dhe raportimit të policisë. IPEM-të që janë raportuar në territorin e Komunës së Klinës në vitin 2015, që në mënyrë të veçantë synojnë pjesëtarët e komunitetit serb, kanë zbuluar se raportimi i Policisë së Kosovës shpesh ka minimizuar elementët ndëretnik kur është raportuar mbi incidentet që kanë përfshirë pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme.<sup>4</sup> Si të tilla, ato shpesh qëndrojnë diametralisht kundër deklaratave të politizuara të bëra nga politikanët serbë të Kosovës dhe përfaqësues të qeverisë serbe, por edhe perceptimin e komunitetit serb në vetë territorin e komunës së Klinës.

<sup>2</sup> KËSHILLI I SIGURIMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA'Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë', (Dokumenti S/2015/74, 30 janar, 2015), fq. 5 paragrafi 24;

<sup>3</sup> ECMI KOSOVA. 'ECMI Kosova dënon bllokimin e dhunshëm të Hyrjes në Kishën Ortodokse Serbe në Gjakovë dhe u bën thirrje autoriteteve të Kosovës që të sigurojnë qasje të lirë dhe të papenguar në vendet e kultit' (6 janar, 2015);

<sup>4</sup> ECMI KOSOVA. 'Mbi incidentet e fundit të sigurisë në komunën e Klinës dhe procesin e vështirë të kthimit' (21 maj, 2015);



Aftësia e institucioneve të Kosovës për të ndjekur penalisht dhe gjykuar rastet e veprave etnikisht të motivuara gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e një ndjenje të sundimit të ligjit, sigurisë dhe besimit në institucionet në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve. Kur shikohen statistikat e incidenteve ndëretnike të ofruara nga Policia e Kosovës (PK), Prokuroria dhe Gjyqësori, numrat janë shumë të ulët. Për shembull, në vitin 2016, gjyqësori ka pranuar vetëm gjashtë raste të krimit të urrejtjes sipas nenit 147 të Kodit Penal (KP). Numri i ulët i rasteve paraqet një mospërputhje të perceptimit të përgjithshëm të njerëzve për sa i përket incidenteve ndëretnike dhe numrit faktik të rasteve që janë trajtuar në institucionet zyrtare të Kosovës. Që të kuptohet, megjithatë, se në rastet kur një krim përfshinë rrethana të tjera rënduese (për shembull, një vjedhje etnikisht të motivuara që përfundon me dhunë fizike ose me viktima që përjetojnë dhunë fizike, këto raste do të karakterizohen si sulm fizik dhe jo si një vjedhje apo vepër etnikisht e motivuar), statistikat reflektojnë peshën e krimeve të rënda, dhe jo gjithmonë atë të krimeve apo veprave me motive etnike.

Ky raport ka për qëllim të ofrojë një ekzaminim të plotë të faktorëve të ndryshëm që shpjegojnë këtë mospërputhje ndërmjet perceptimit të pjesëtarëve të komuniteteve, mbulimit të këtyre rasteve nga media dhe raportimit të policisë dhe rasteve të gjykuara të IPEM-ve. Raporti, për më tepër, do të analizojë kuadrin ligjor ekzistues për krimet ndëretnike në Kosovë, do të shqyrtojë, më tej, procesin e raportimit të PK-së dhe procedurën penale të këtyre incidenteve në Prokurorinë dhe Gjyqësorin e Kosovës. Veç kësaj, do të analizohen Statistikat më të fundit nga këto institucione, dhe më në fund do të shqyrtohet edhe përgjegjësia e medieve dhe politikanëve të Kosovës.

## **2. METODOLOGJIA**

Ky raport shqyrton procedurat e përdorura të raportimit të PK-së, me një fokus të veçantë në rastet e IPEM-ve, nga hetimi fillestar dhe faza e raportimit (duke përfshirë deklaratat e bëra në media) për sa i përket shkëmbimit dhe ofrimit të të dhënave dhe harmonizimin me gjyqësorin. Raporti gjithashtu do të prezantojë dhe analizojë statistikat në lidhje me krimet ndëretnike që kanë kaluar nëpër procedurat penale. Kjo pasqyrë e përgjithshme e mekanizmave institucionalë dhe bashkëpunimit midis tri institucioneve Policisë së Kosovës, Prokurorisë së Shtetit dhe Gjyqësorit është ofruar për të dhënë një përmbledhje të qartë dhe të nevojshme të sistemit aktual të raportimit dhe ndjekjes së IPEM-ve në Kosovë. Për secilën nga këto aspekte, raporti do të zbulojë sfidat dhe rekomandimet aktuale me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të përkufizimit, raportimit dhe ndjekjes së IPEM-ve.

Raporti bazohet në një përmbledhje, krahasim dhe/ose sintezë të kërkimeve ekzistuese për sa i përket përkufizimeve dhe procedurave për raportimin e IPEM-ve dhe në intervistat me përfaqësuesit e PK-së, Prokurorisë, EULEX-it, OSBE-së, Departamentit të Statistikave brenda Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe përfaqësuesit e Programit Ndërkombëtar të Asistencës për Trajnime në Hetimet Kriminale (ICITAP). Raporti gjithashtu përfshin një rast të vogël studimor të regjistrimit, klasifikimit dhe ndjekjes nga ana e PK-së, Prokurorisë dhe Gjyqësorit të një incidenti që ka ndodhur në vitin 2015 për të ilustruar kompleksitetin e klasifikimit të incidenteve ndëretnike. Raporti synon që në fokus kryesor të ketë IPEM-ët duke përfshirë incidentet ndërmjet personave që u përkasin komuniteteve shqiptar dhe serb. Edhe pse ECMI Kosova pranon se pjesëtarët e pakicave të tjera janë subjekt i incidenteve me paragjykim ose motivim paragjykues, megjithatë kjo nuk është temë e hulumtimit të këtij raporti.

### 3. PËRKUFIZIMI I INCIDENTEVE ETNIKISHT TË MOTIVUARA

#### 3.1 Vërejtje të përgjithshme mbi përkufizimin e incidenteve etnikisht të motivuara dhe krimeve të urrejtjes

Krimet e urrejtjes janë krime të cilat janë të bazuara në paragjykime. Këto vepra janë të bazuara në dy elemente, dhe në qoftë se të dy elementet janë të përfshira apo të pranishme në një krim, ai rast do të përbëjë një krim të urrejtjes. Elementi i parë parashikon se incidenti duhet të jetë një krim sipas KP-së (Kodit Penal). Së dyti, krimi duhet të jetë kryer me një motivim paragjykues, që do të thotë se autori zgjedhë viktimën në bazë të disa karakteristikave të mbrojtura. Viktima apo caku i kryesit mund të jetë një person, një grup personash apo një pronë që është e lidhur me një grup që ndan një karakteristikë të veçantë, për shembull, një kishë, një xhami apo një sinagogë. Një karakteristikë e mbrojtur është një karakteristikë që është e zakonshme për një grup, siç bie fjala gjuha, feja, etnia apo ndonjë emërues tjetër i përbashkët.<sup>5</sup> Një vepër kriminale e kryer kundër një personi me aftësi të kufizuara për shkak të metave dhe paaftësisë së tij/saj, pra, mund të klasifikohet si një krim me motiv urrejtjeje.

Referimi më lartë nënkupton se një incident që përfshin pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme nuk do të thotë menjëherë se krimi është një krim urrejtjeje. Vetëm në qoftë se ka pasur një *motivim paragjykues* prapa veprimeve të kryera penale, rasti duhet të klasifikohet si një krim urrejtjeje.

Në maj të vitit 2015, një incident ka ndodhur kur një banor serb i fshatit Pasjan të komunës së Parteshit, është raportuar të ketë qenë goditur me thikë nga dy banorët shqiptarë të fshatit fqinj Llashticë. Incidenti, i cili është trajtuar si temë në një deklaratë informative të ECMI Kosovës,<sup>6</sup> është një shembull i mirë për të ilustruar kompleksitetin e përcaktimit/përkufizimit të motivit të incidenteve ndëretnike. Incidenti ka ndodhur pas një manovrimi gjatë parakalimit me veturë në rrugë që gati sa nuk kishte shkaktuar një aksident të rëndë trafiku. Përkundër faktit se nuk ka ardhur deri te përplasja apo ndeshja e makinave, viktima dhe të pandehurit janë përfshirë në një agresion verbal që ka rezultuar me përleshje fizike me ç'rast viktima ka pësuar lëndime trupore.

Çështja e motivi pas këtij incidenti është ngritur menjëherë marrë parasysh faktin që kryesit e veprës ishin shqiptarë të Kosovës dhe viktima ishte një pjesëtarë i komunitetit serb të Kosovës. Përfaqësuesit e PK-së me shpejtësi kanë lëshuar një kumtesë se shkak i drejtpërdrejtë i këtij incidentit kishte të bënte me një zënkë për shkak të një ngatërrese në trafik dhe se incidenti nuk ishte etnikisht i motivuar. Në mediet serbe, megjithatë, dhe në reagimet e serbëve të Kosovës dhe përfaqësuesve zyrtarë serbë është raportuar dhe përcaktuar si incident etnikisht i motivuar me qëllim që të trembë pjesëtarët e komunitetit serb të përndjekë larg Kosovës serbët e mbetur në pjesën jugore të Kosovës.<sup>7</sup> Kjo ilustron tendencën e serbëve të Kosovës dhe politikanëve serbë për t'u fokusuar në komponentin etnik të incidenteve ndëretnike dhe në përcaktimin/përkufizimin e këtyre incidenteve, si etnikisht paragjykuara në mënyrë që të politizojnë incidentet që përfshijnë pjesëtarët e komunitetit serb me pjesëtarë të komunitetit shumicë. Përveç kësaj, ky rast ilustron tendencën e PK-së për të minimizuar çdo element apo motiv të mundshëm etnik për ta klasifikuar si një incident ndëretnik në fazën e raportimit fillestar, ndoshta nga frika e politizimit të këtyre incidenteve.

<sup>5</sup> OSBE/ODIHR. 'Hate Crime Laws – a Practical Guide' Shqip: 'Ligjet mbi krimet e urrejtjes – një udhëzues praktik' (2009).

<sup>6</sup> ECMI KOSOVA. 'Me rastin e incidentit të fundit në Pasjan' (10 maj, 2015)

<sup>7</sup> B92. 'Da se kazneonikoji su napadali' Shqip: 'të dënohen ata që kanë sulmuar' (5 maj, 2015).

Çështja e provave dhe kompleksitetit të përkufizimit të motivimit paragjykes është gjithashtu e ilustruar edhe në këtë rast, dikush mund të argumentojë se ky është një rast i qartë i një inati apo ngatërrese në rrugë/trafik që është përshkallëzuar në përleshje fizike, pa përfshirje të elementit të motivimit paragjykes, ndërsa të tjerë mund të argumentojnë se goditja me thikë mund të mos kishte ndodhur në të vërtetë nëse palët nuk do të kishin qenë të përkatësive të ndryshme etnike dhe të argumentojnë më tej për mundësinë e ekzistencës së motivimit paragjykes.

### 3.2 Korniza ligjore

Standardet me të cilat janë gjykuar krimet e urrejtjes dhe ato etnike në Kosovë janë në linjë me standardet ndërkombëtare dhe si të tilla janë të përshtatshme, në teori, për mënyrën e duhur të kategorizimit dhe raportimit të incidenteve që përfshijnë komunitetet pakicë. Legjislacioni aktual në lidhje me krimet e urrejtjes dhe incidentet e motivuara etnikisht mund të gjendet në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, sipas nenit 147.

Dispozita e parë dhe e dytë e nenit 147 të KP-së thonë se kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe tjera të tilla që jetojnë në Republikën e Kosovës, mund të dënohen me gjobë ose me burgim prej një-(1) deri në tetë-(8) vjet.

Dispozita e tretë e nenit 147 numëron mjetet me të cilat kushdo që kryen veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni përmes shtrëngimit, rrezikimit tësigurisë, përqeshjes së simboleve kombëtare, racore, etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet apo varrezat, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. Dispozita e fundit e nenit 147 parashikon rrethana të ndryshme rënduese, ku vepra konsiderohet e rëndë dhe që për pasojë mund të çojë në një dënim më të ashpër. Domethënë, kryerja e këtyre veprave penale në mënyrë sistematike duke përfutur nga pozita apo autoriteti i tij/saj, konsiderohet vepër më e rëndë dhe për këtë arsye i/e akuzuari/a dënohet me burgim prej dy-(2) deri në dhjetë-(10) vjet.<sup>8</sup>

Është e rëndësishme të theksohet se neni 147 nuk është i kufizuar vetëm për sa i përket motivimit paragjykes për shkak të etnisë apo religjionit. Kë nën është gjithashtu i zbatueshëm për veprat penale, ku kryesi ka sulmuar pjesëtarë të komunitetit LGBT apo kundër personave me aftësi të kufizuara.

Neni 147 është megjithatë i kufizuar, meqë përdorimi i këtij neni megjithatë nuk mbulon synimet potencialisht etnikisht të motivuara të incidenteve/krimeve. Përdorimi ekskluziv i nenit 147 do të thotë se regjistrimi i incidenteve nuk do të marrë në konsideratë ndonjë nxitje eventuale për motive paragjyqese etnike të incidentit. Prandaj është sugjeruar që ky kufizim në këtë nen të mund të trajtohen duke zbatuar nenin 74 (2.12) të Kodit Penal, i cili nen merr në konsideratë motivimin dhe/apo qëllimet prapa një krimi.<sup>9</sup> Ky nen parashikon që përmbajtja si më poshtë mund të konsiderohet si një rrethanë rënduese konkretisht "nëse vepra penale është kryer kundër një personi, grupi të personave apo pronës për shkak të përkatësisë etnike ose origjinës kombëtare, kombësisë, gjuhës, besimit fetar, ateizmit, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë së tyre me personat që kanë karakteristikat e lartpërmendura."<sup>10</sup>

<sup>8</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës Kodi Nr. 04/L-082 (20 prill, 2012), neni 147;

<sup>9</sup> KOMISIONI EVROPIAN. Raporti i Komisionit për Parlamentin dhe Këshillin Evropian, Raporti i tretë i Progresin për Kosovën\* në kërkesat e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave (COM (2015) 906 përfundimtar, 18 dhjetor, 2015), fq. 10;

<sup>10</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 74(2.12);

Neni 74, është, megjithatë, një dispozitë e përgjithshme dhe nuk është një dispozitë që ofron një bazë ligjore për një veprë penale që një gjykatës mund ta përdorë në mënyrë të pavarur në vendimin e tij/saj. Gjyqtari mund të përdorë vetëm nenin 74 si një bazë ligjore për të zgjatur dënimin për shkak të rrethanave rënduese. Megjithatë, Neni 74 (2.12) nuk paraqet një mjet të rëndësishëm nëpërmjet të cilit gjyqtarët mund të trajtojnë veprat ndëretnike, të cilat nuk janë të mbuluara nga neni 147, dhe të shfrytëzojnë atë nen me qëllim të zgjerimit të dënimin. Megjithatë, Neni 74 (2.12) ende nuk është pasqyruar në ndonjë prej vendimeve të gjykatave.<sup>11</sup>

Përveç kësaj, neni 333 që i referohet shkatërrimit dhe dëmtimit të pronës dhe neni 179 për vrasje të rënda të dyja këto nene përmbajnë dispozita që rrisin peshën e veprës, nëse vrasja dhe dëmtimi i pronës është kryer me motivim paargjykses.<sup>12</sup>

### 3.3 Struktura përkatëse institucionale: Policia e Kosovës, Prokuroria dhe Gjyqësori

Sundimi i ligjit në Kosovë mbështetet në tre institucione, përkatësisht Policinë e Kosovës, prokuroritë publike dhe gjykatat. Çdo procedurë penale do të procedohet nga të tre institucionet e lartpërmendura dhe do të kalojë nëpër katër faza të ndryshme: fazën e hetimit, fazën së aktakuzës dhe të pranimit të fajit, fazën së shqyrtimit gjyqësor dhe fazën së mjetit juridik.<sup>13</sup> Procedurat penale dhe bashkëpunimi në mes të PK-së dhe prokurorëve publikë janë shumë mirë të rregulluara në Kodin e Procedurës Penale (KPP). Grafiku i mëposhtëm ilustron rolet e ndryshme që të tre institucionet kanë në procedimin penal të një veprë penale.<sup>14</sup>



<sup>11</sup> EULEX, Raporti i Progresit të Kompaktit(shtator 2015), fq. 12.

<sup>12</sup> Kodi Penal, neni 333(4) dhe neni 179(1.10).

<sup>13</sup> Ibid., neni 68.

<sup>14</sup> Ky grafik është i bazuar në Kapitullin IX të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe në intervistat me shefin e PK-së për Çështje Ligjore, realizuar më 17 maj 2016 dhe me Koordinatorin e krimeve të urrejtjes ndëretnike në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, mbajtur më 26 maj 2016.

Si institucioni i parë reagues, PK-ja janë të parët që dalin në vendin ku ka ndodhur incidenti. Nëse patrulla e parë e policisë dyshon se një vepër penale ka ndodhur ajo menjëherë do të fillojë një hetim nismëtar për të hetuar nëse ekziston dyshim i arsyeshëm se një vepër penale ka ndodhur me të vërtetë dhe do të paraqesin një raport fillestar mbi incidentin.<sup>15</sup> Sapo që policia të konstatojë se ekziston dyshim i arsyeshëm se një vepër penale është kryer, PK-ja do t'i ofrojë një raport brenda 24 orëve zyrës së prokurorisë kompetent të shtetit. Prokurori i shtetit pastaj vendos nëse do të iniciojë procedurë penale apo jo.<sup>16</sup> Në këtë mënyrë, mund të fillohet një hetim vetëm me vendim të prokurorit.<sup>17</sup> Prokurori i shtetit mundet pastaj të ndërmerr veprimet hetimore, por gjithashtu mund të autorizojë policinë për të ndërmarrë veprimet hetimore të cilat ka të bëjë me mbledhjen e provave shtesë.<sup>18</sup> Duke qenë se KPP bën dallimin ndërmjet krimeve më pak të rënda dhe kundërvajtjeve dhe krimeve të rënda, procedurat hetimore do të jenë të ndryshme në varësi të natyrës së krimin të kryer.<sup>19</sup> Siç parashikohet me nenin 147 të KP-së se çdo incident me motiv paragjykses mund të çojë në masën e dënimit me burg deri në pesë vjet, çdo incident që përfshinë një krim të urrejtjes do të procedohet si një krim i rëndë, edhe nga PK-ja edhe nga Zyra e Prokurorit të Shtetit.

Kur rasti t'i jetë dërguar prokurorisë kompetente të shtetit është përgjegjësi e prokurorit për të siguruar mbledhjen e duhur të të gjitha provave relevante, qoftë nga prokuroria apo policia. Është gjithashtu përgjegjësi ekskluzive e prokurorisë për të klasifikuar natyrën e veprës penale dhe për të gjetur nene të zbatueshme të Kodit Penal. Në përputhje me rrethanat, prokurori do të analizojë provat dhe do të vendosë nëse ka informacion të mjaftueshëm për të konstatuar se ekziston një dyshim i mirë bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale. Nëse është kështu, prokurori i shtetit mund të paraqesë një aktakuzë dhe në bazë të kësaj aktakuze, mund të kryhet procedura para gjykatës kompetente.<sup>20</sup>

Në përputhje me parimin e pavarësisë së institucioneve gjyqësore, Gjykata do të analizojë provat e paraqitura, dhe mund të kërkojë dëshmi të tjera që do të mblidhen nga prokuroria ose policia.

Duke pasur parasysh përfshirjen e tri institucioneve në procedurën penale, është e rëndësishme që këto institucione të kenë një mekanizëm të gjerë dhe funksional të bashkëpunimi për arritjen e një rezultati efektiv dhe një zbatim të kënaqshëm të sundimit të ligjit. Kapitulli tjetër do të identifikojë sfidat për sa i përket përkufizimit, raportimit dhe analizimit të IPEM-ve nga tri institucionet përkatëse.

---

<sup>15</sup> Ibid., neni 70(1).

<sup>16</sup> Ibid., neni 70(4).

<sup>17</sup> Policia, megjithatë, mund të marrë hapa të parë për të filluar një hetim fillestar në përputhje me nenet 69 dhe 70 të KPP-së.

<sup>18</sup> Ibid., neni 104(1) dhe neni 104(2).

<sup>19</sup> Kundërvajtjet dhe krimet më pak të rënda janë vepra penale që janë të dënueshme vetëm me gjobë ose me burgim nën tre vjet, ndërsa krimet e rënda janë të dënueshme me burgim më shumë se tre vjet, Kodi i procedurës penale, neni 101 (2).

<sup>20</sup> Kodi i procedurës penale të republikës së Kosovës, neni 240(1).

## 4. SFIDAT QË LIDHEN ME PËRKUFIZIMIN DHE RAPORTIMIN E INCIDENTEVE ETNIKISHT TË MOTIVUARA

### 4.1. Mungesa e mbledhjes, analizimit, dhe shpërndarjes së të dhënave

Për sa i përket strukturave të qeverisë në lidhje me procesin e raportimit, pengesë e madhe për raportimin e duhur dhe regjistrimin e IPEM-ve është mungesa e ndarjes dhe/apo ofrimit të të dhënave thelbësore ndërmjet institucioneve të ndryshme. Nëpërmjet mekanizmit aktual të mbledhjes dhe ndarjes së të dhënave, është shumë e vështirë për të kryer ndonjë lloj të analizimit të të dhënave, jo më të bazohet politika apo proceset e vendimmarrjes në lidhje me çështjet e komuniteteve në të dhënat konkrete statistikore. Para së gjithash, sistemi aktual ndjekjes së rasteve nuk është uniform po i njëjtë në të gjithë departamentet. Sistemit i mungon një numër universal i cili do të mund t'i caktohej apo vendosej rasteve gjatë procedimit të tyre nëpërmjet sistemit të drejtësisë nga PK-ja tek Prokuroria dhe më pas Gjyqësori.

Pas rekomandimeve të paraqitura nga Komisioni Evropian,<sup>21</sup> një sistem i ri i informacionit mbi menaxhimin e rasteve është aktualisht duke u zhvilluar dhe do të jetë apo vihet në funksion veprues nga viti 2017. Ky sistem do të unifikojë të dhënat gjyqësore të shtatë institucioneve, përkatësisht PK-së, Prokurorisë së Shtetit, Gjyqësorit, Doganave, Zyrës së Gjendjes Civile, Njësisë për Hetimin dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Kur të jetë plotësisht veprues apo funksional, sistemi i ndjekjes dhe raportimit do të përkufizojë dhe përcaktojë çdo rast me një numër unik të rastit gjatë procedimit të rastit përkatës nëpër institucionet të cilat do të mundësojnë përcjelljen e lehtë të të gjitha rasteve të proceduara nga këto institucione.<sup>22</sup>

### 4.2. Procedurat e raportimit të Policisë së Kosovës për incidentet potencialisht etnikisht të motivuara

Kur i përgjigjen një incidenti, PK-së i kërkohet të plotësojë dhe/apo hartojë një raport për incidentin. Në kuadër të këtij raporti mbi incidentin, oficeri përgjegjës duhet të shënjojë në katrorin që tregon motivin prapa incidentit njërin nga opsionet e mëposhtme: mosmarrëveshje/zemërim, familjar, etnik, politik ose motiv personal.<sup>23</sup> Është e caktuar pra në këtë pikë që oficeri policor duhet të zgjedhë nëse një rast është apo nuk është etnikisht i motivuar - duke lënë shumë pak hapësirë për hamendësim, motive të mundshme etnike apo mundësinë për e motive të shumta. Është më se e mundur që, edhe pse një incident mund të mos ketë qenë fillimisht i motivuar nga një paragjykim etnik, por ka përfshinë një paragjykim të tillë pa vetëdije, apo perceptim të paragjyqimeve etnike.<sup>24</sup> Sistemi i raportimit të policisë gjithashtu përfshinë një tjetër detaj të raportimit, kur bëhet fjalë për raportimin e rasteve të ndjeshme. Çdo incident i dyshuar të ketë motivim paragjyqës duhet të trajtohet si një rast i ndjeshme (si çdo rast tjetër i krimeve të rënda si për shembull një vrasje), dhe për këtë arsye raportimi kërkon që të plotësohet edhe një formë e dytë e raportit. Ky raport, i quajtur 'raport i shpejtë', përmban një pjesë në të cilën u kërkohet zyrtarëve policorë që të konfirmojnë apo kundërshtojnë se incidenti për të cilin raportohet është i motivuar etnikisht. Për këtë arsye, zyrtari/ët e policisë duhet të përgjigjet/en me po/jo, apo se nuk e kanë të njohur këtë gjë, në pjesën ku raporti i shpejtë në mënyrë të veçantë kërkon të tregohet nëse incidenti ishte i motivuar etnikisht.

<sup>21</sup> Siç është në dukje nga Komisioni Evropian në Raportin e dytë për progresin e Kosovës në përbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, institucionet e Kosovës do të mund të përfitojnë duke zhvilluar një qasje të përbashkët dhe një koordinim të përmirësuar. Ata gjithashtu kanë rekomanduar që të "zhvillohet një sistem i integruar i menaxhimit të rasteve që lejon ndjekjen e çështjeve penale që nga faza e hetimeve deri tek zhvillimi i rasteve në prokurori dhe shqiptimi i dënimeve nga gjyqësori". KOMISIONI EVROPIAN. Raporti i Komisionit për Parlamentin dhe Këshillin Evropian mbi raportin e dytë për progresin e Kosovës në përbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave (COM (2014) 488, 24 koeik 2014), fq. 5 dhe 7.

<sup>22</sup> Intervistë me Koordinatorin për krimet e urrejtjes ndëretnike, Zyra e Prokurorit të Shtetit Prishtinë, 24 maj 2016.


<sup>23</sup> Intervistë me shefin e Çështjeve Ligjore, Policia e Kosovës, mbajtur më 17 maj 2016.

<sup>24</sup> Siç e ilustruar në rastin e incidentit në Pasjan, shih më lart pjesën 3.1.

Në klasifikimin e një incident, PK-ja përdorë përkufizime specifike duke kategorizuar incidentet si krim të urrejtjes apo incident me motive etnike përveç përkufizimit bazë të një krimi të urrejtjes apo incidenti me motive etnike të parashikuar në nenin 147 të KP. Sipas këtyre parametrave më të përkufizuar, krimet e urrejtjes dhe ato etnike janë çdo akt apo kërcënim i ushtrimit të dhunës, dëmtimit të pronës, shqetësimit, frikësimit, si dhe krimeve të tjera të pa përfshira këtu, të nxitura ose të motivuar nga një paragjykim ndaj racës, fesë, përkatësisë etnike, gjinisë, orientimit seksual ose paaftësisë fizike.

Oficerët e policisë duhet të kryejnë një sërë procedurash në vendngjarjepër të klasifikuar një incident. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: sigurimin e vendit të krimit, mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, ruajtjen e ndonjë dëshmie fizike, dhe mbledhjen e deklaratave nga palët e përfshira dhe dëshmitarët në kohë reale.<sup>25</sup> Përveç kësaj, si pjesë e trajnimit themelor të gjithë zyrtarët policorë ndjekin një trajnim mbi të drejtat e njeriut që përfshin edhe pjesën që trajton krimet e urrejtjes.<sup>26</sup>

### Numri i incidenteve potencialisht etnikisht të motivuara të raportuara nga PK-ja



Grafiku ilustron një tendencë të qartë të rënies që prej vitit 2011 të raportimit të IPEM-ve nga PK-ja. Të dhënat paraqesin rastet vetëm kur prokurori e ka autorizuar hetimin.<sup>27</sup> Sipas PK-së, klasifikimi i krimeve të mundshme me motive etnike është zbatuar në mënyrë të ndryshme para vitit 2011 dhe këto statistika nuk janë dhënë sepse në fakt ato di të ishin në kundërshtim me të dhënat e kohëve të fundit. Në procedurën e klasifikimit të rasteve të zbatuar para viti 2011, PK-ja ka klasifikuar ndonjë incident që ka përfshire pjesëtarë të etnive të ndryshme si IPEM, që ka dërguar apo rezultuar ma në figura apo numra, konsiderueshëm më të lartë, të IPEM-ve në statistikat e PK-së. Që nga viti 2016, PK-ja nuk mban më statistika mbi IPEM-ët e regjistruar, pasi që kjo çështje do të jetë përgjegjësi ekskluzive e Prokurorit të Shtetit.<sup>28</sup>

Në të vërtetë, raportet e PK-së nuk kanë konkluzion të fundmë në kategorizimin e incidenteve si të motivuara etnikisht apo jo. Përgjegjësinë për të kategorizuar apo përkufizuar një rast e ka prokurori dhe konkluzionin e fundit të kategorizimit e ka gjyqësori. Megjithëse PK-ja është përgjegjëse për vlerësimin, raportimin dhe kategorizimin fillestar të një incidenti, në qoftë se pas hetimeve të mëtejshme, Zyra e prokurorit apo gjyqtari i autorizuar vlerëson nëse incidenti ka qenë i motivuar etnikisht apo jo, ata mund të ri-kategorizojnë atë incident dhe ta ndjekin më tej si të tillë.

<sup>25</sup> Kodi i procedurës penale të Republikës së Kosovës, neni 70.

<sup>26</sup> Intervistë me shefin e Çështjeve Ligjore, Policia e Kosovës, mbajtur më 17 maj 2016.

<sup>27</sup> Intervistë me Këshilltarin e EULEX-it të Zëvendësdirjtorit të Përgjithshëm të Operacioneve të PK-së /zëvendës shefit të Njësisë këshilluese të Policisë dhe çështjeve kufitare, mbajtur në Prishtinë më 7 korrik 2016.

<sup>28</sup> Intervistë me shefin e Çështjeve Ligjore, Policia e Kosovës, mbajtur më 17 maj 2016.

Roli primar i PK-së në procesin e raportimit dhe zgjidhjen e një incidenti nuk është që të bëjë një vlerësim përfundimtar të motivimit etnik prapa një incidenti, por për të mbledhur prova të vështira dhe për të raportuar në mënyrë rigorozë mbi çështjen apo rastin. Kjo duhet të përfshijë identifikimin e ndonjë elementi apo të faktorëve që mund të çojnë në konkluzionin e fundmë se një incident ka qenë etnikisht i motivuar. Me fjalë të tjera, PK-ja duhet të fokusohet në elemente të cilat mund të tregojnë për motive etnike pas një incidenti dhe të marrin në konsideratë perceptimin e njerëzve apo motivet me bazë etnike.

PK-ja procedon IPEM-ët së bashku me procedura të mirë rregulluara dhe nëpërmjet strategjive të zhvilluara me kujdes, strukturave dhe procedurave standarde të veprimit që kanë kapacitetin dhe aftësinë për të proceduar në mënyrë efektive incidentet ndëretnike.<sup>29</sup> Megjithatë, kur shikon në statistikat e paraqitura nga ana e PK-së, numri i IPEM-ve të regjistruar është shumë i ulët. Siç u përmend më herët, mekanizmi aktual i raportimit nuk lejon përkufizimin për motive të shumëfishta apo për paragjykime të mundshme etnike. Përveç kësaj, ekziston një rrezik real që zyrtarët e PK-së hezitojnë të klasifikojnë një incident si incident me motive etnike, për shkak të pasojave politike dhe përshkallëzimit që mund të pasojë. Mediat dhe përfaqësuesit politikë të komuniteteve pakicë shpesh, së pari, vënë theksin tek motivi etnik, PK-ja duket se ka një tendencë për të mohuar bile edhe mundësinë e ekzistencës së motivit etnik ose perceptimet, dhe vë theksin te motivi i kryesor i një incidenti dhe i mbahet fuqishëm atij qëndrimi në Raportin e policisë, i cili nuk lejon hamendësime mbi motivin e vërtetë ose për perceptimet e vetë viktimës. Ndërsa është padyshim e justifikueshme që rastet të përkufizohen me faktorë të tjerë më banalë dhe materialapo motive jo përkatëse, të tilla si përfitim absolut financiarë i kryesit, mospërfillja e elementeve etnike prapa këtyre incidenteve nuk është qasja e duhur.

#### **4.3. Klasifikimi dhe mbledhja e të dhënave nga Zyra e Prokurorisë së Shtetit për incidentet potencialisht etnikisht motivuara**

Gjatë vitit 2015 Prokurori i Shtetit ka regjistruar 11 raste ndëretnike brenda sistemit të prokurorisë së shtetit. Statistikat nga vitet e kaluara nuk janë lëshuar, sepse statistikat kanë qenë dukshëm më të larta dhe, në fakt, nuk do të përfaqësonin numrin aktual të veprave penale të kryera në bazë të nenit 147. Kjo ka ndodhur për shkak se Prokuroria e Shtetit deri në vitin 2015 ka klasifikuar dhe kategorizuar çdo vepër penale që ka përfshirë dy etni të ndryshme si një IPEM.

Siç u përmend më lartë në raport, Prokuroria e Shtetit që nga viti 2016 është përgjegjëse për mbledhjen e statistikave për sa i përket IPEM-ve nga PK-ja dhe prokurori, dhe ka caktuar një koordinator për krimet ndëretnike. Ky koordinator do të mbledhë dhe raportojë mbi statistikat e incidenteve ndëretnike të pranuar nga PK-ja dhe zyrat e prokurorëve lokalë në Kosovë. Qëllimi përfundimtar është që të paraqiten statistika koherente dhe uniforme nga PK-ja dhe Zyra e Prokurorit të Shtetit.

Edhe pse një sistem i koordinuar për përcjelljen e të dhënave është padyshim i vlefshme dhe i lavdërueshëm, krijimi i një metode uniforme apo të standardizuar të mbledhjes së të dhënave statistikore nga PK-ja dhe Prokurori i Shtetit mund të sjellë deri tek humbja e të dhënave të rëndësishme, meqë nuk do të paraqitet mospërputhjet eventuale në mes të dy niveleve të procedurave penale.

<sup>29</sup> Intervistë me Këshilltarin e EULEX-it të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Operacioneve të PK-së / zëvendës shefit të Njësisë këshilluese të Policisë dhe çështjeve kufitare, mbajtur në Prishtinë më 7 korrik 2016.



Marrë parasysh faktin s Prokuroria është më shumë institucion i orientuar në dëshmi sesa PK-së i kërkohet që të jetë, statistikave mund të ulin edhe më shumë potencialin e motiveve etnike dhe të përshkruajnë një pamje më pak përfaqësuese të statusit të vërtetë të një rasti. Një fokus më i zgjeruar në trajnimin e përbashkët në mes të dy institucioneve, si një metodë për të arritur një përkufizim dhe qasje të përbashkët për sa i përket IPEM-ve, do të dërgonte tek një qasje më e qëndrueshme dhe përfaqësuese, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian.<sup>30</sup>

#### 4.4 Praktikave gjyqësore dhe Mbledhja e të dhënave

Kategorizimi përfundimtarë i një incidenti si etnikisht i motivuar apo jo do të bëhet brenda institucionit të gjyqësorit. Statistikat e fundit ato të vitit 2014 dhe 2015 tregojnë se në vitin 2014 ka pasur nëntë raste të trajtuara të në bazë të nenit 147 të KP, gjashtë ishin raste të reja dhe tre të tjera kanë qenë nga rastet e grumbulluara të periudhës raportuese të vitit 2013. Nga këto nëntë raste, katër janë zgjidhur dhe pesë ishin ende në pritje të një zgjidhje në fund të periudhës raportuese. Në vitin 2015 ka pasur gjashtë raste të reja të proceduara, gjithsej njëmbëdhjetë raste për shkak të numrit të rasteve të grumbulluara nga viti 2014. Tre prej tyre janë zgjidhur gjatë periudhës raportuese dhe të tetë ishin ende në pritje të një zgjidhje në fund të periudhës raportuese.

Rastet sipas Nenit 147 të Kodit Penal të Kosovës në vitet 2013-2015:<sup>31</sup>

Periudha Raportuese	2013	2014	2015
Lëndët e grumbulluara nga periudha e mëparshme e raportimit	2	3	5
Lëndë të reja të pranuar gjatë periudhës raportuese	4	6	6
<b>Rastet në total</b>	<b>6</b>	<b>9</b>	<b>11</b>
Dënimet që kanë rezultuar me burg	0	0	1
Dënimet që kanë rezultuar me gjobë	1	1	0
Dënimet me kusht	0	2	0
Rastet e zgjidhura në mënyra të tjera	2	1	2
Totali i rasteve të zgjidhura	3	4	3
Rastet në pritje të një zgjidhje në fund të periudhës raportuese	3	5	8

Duke shikuar të dhënat statistikore, është e qartë se numri i rasteve të gjykuara në bazë të nenit 147 është dukshëm më i ulët se numri i rasteve të cilat janë KP-ja i regjistruar si incidente potencialisht etnikisht të motivuara. Arsyet për këtë rënie në numër janë të shumta.

Së pari, kur policia në raportin e tyre mbi incidentin kategorizon një incident si potencialisht të etnikisht të motivuar, kategorizimi është i bazuar vetëm në dyshime. Ky dyshim mund të hidhet në procedurën gjyqësore për shkak të mungesës së provave. Gjykatat dhe vendimet e tyre mund të jenë bindëse vetëm nga provat e paraqitura dhe jo nga dyshimet.

<sup>30</sup> KOMISIONI EVROPIAN: COM (2014), fq. 5.

<sup>31</sup> Të dhëna statistikore nga Departamenti i statistikave të Këshillit gjyqësor të Kosovës. Të dhëna të ofruara nga një anëtar i Këshillit gjyqësor më 12 maj 2016.

Së dyti, të dhënat e lartpërmendura statistikore nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) përshkruajnë vetëm rastet kur neni 147 është neni i vetëm i referuar në gjykim. Çdo gjykim ku neni 147 është përdorur së bashku me një tjetër nen, nuk do të përfshihet në statistikat e paraqitura më lartë, duke i bërë të dhënat për sa i përket nenit 147 të ndryshueshme dhe pjesërisht të zbuluara. Përveç kësaj, statistikat përfshijnë të gjitha veprat e kryera sipas nenit 147, prandaj statistikat përfshijë edhe veprat e kryera me motivim paragjykes për shkak të dallimeve racore apo orientimit seksual. Numri i saktë i rasteve të gjykuar në bazë të paragjyqimeve etnike është i panjohur.

Për fat të keq, Këshilli Gjyqësor nuk ruan apo mban asnjë statistikë mbi nenin e përmendur më parë 74 (2.12) të KP, i cili ofron mundësinë për të zgjeruar një dënim për shkak të rrethanave rënduese si motivim paragjykes. Nëse do të mbaheshin statistikat për sa i përket këtij neni, ato ndoshta do të jepnin një pamje më të gjerë dhe më të saktë të numrit të rasteve etnikisht të motivuara në procedurat gjyqësore. Sipas Raportit të Kompaktit të EULEX-it të vitit 2015, neni 74 (2.12) nuk është reflektuar në asnjë aktgjykim.<sup>32</sup>

#### 4.5 Monitorimi i incidenteve të mundshme etnikisht të motivuara nga OSBE-ja dhe EULEX-i

OSBE-ja dhe EULEX-i trajtojnë IPEM-ët si një fushë të rëndësishme të përqendrimit në punën e tyre në Kosovë. Publikimi i fundit Raporti i OSBE-së për vlerësimin e drejtave të komuniteteve, prezantuan numrin e incidenteve që "kanë pasur potencial të ndikojnë negativisht perceptimet e pjesëtarëve të komuniteteve për sigurinë në nivel komunal." Numri i përgjithshëm i incidenteve të raportuara ishte 479, që në krahasim me institucionet e Kosovës është dukshëm më i lartë.<sup>33</sup> Duhet të theksohet se statistikat e OSBE-së nuk janë ekskluzivisht të përqendruar vetëm në IPEM-ët, por gjithashtu deri një farë mase mund të përfshijnë incidentet ku palët e përfshira janë nga prejardhje të ndryshme etnike, por motivi i krimit nuk është konfirmuar të ketë qenë motiv paragjykes.<sup>34</sup> Me fjalë të tjera, OSBE-ja përdor një përkufizim më të gjerë për klasifikimin krahasuar me atë që përmbahet në nenin 147 të KP. EULEX-i gjithashtu monitoron IPEM-ët në Kosovë, por nuk publikon statistika në lidhje me këtë çështje. EULEX-i gjithashtu vendos një prag më të ulët sesa KP për sa i përket klasifikimit të një incidenti si IPEM, meqë përfshinë rastet që *potencialisht* janë incidente ndëretnike.<sup>35</sup> Megjithatë, monitorimi i EULEX-it dhe OSBE-së nuk duhet të hidhet poshtë si i ekzagjeruar. Në fakt, numri aktual i IPEM-ve që po ndodhin në Kosovë, besohet të jetë dukshëm më i lartë sesa numrat e prezantuar nga OSBE-ja, pasi numri i incidenteve të paregjistruara është i panjohur.

Nën raportimi është një shqetësim serioz. Marrë në konsideratë se shumë nga pjesëtarët e pakicave nuk kanë besim në autoritetet zyrtare, shumica e incidenteve nuk raportohen, duke krijuar një pasiguri në lidhje me statistikat e regjistruara.<sup>36</sup>

---

<sup>32</sup> EULEX: Raporti Kompakt, fq 12.

<sup>33</sup> MISIONI I OSBE-SË NË KOSOVË, Raporti i vlerësimit të drejtave të komuniteteve, edicioni i katërt (nëntor 2015), fq.9.

<sup>34</sup> Intervistë me një zyrtar të lartë për komunitete të OSBE-së në Departamentin për të drejta të njeriut dhe komunitete, Zyra e OSBE-së në Prishtinë, 6 korrik 2016.

<sup>35</sup> Intervistë me Këshilltarin e EULEX-it të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Operacioneve të PK-së / zëvendës shefit të Njësisë këshilluese të Policisë dhe çështjeve kufitare, mbajtur në Prishtinë më 7 korrik 2016.

<sup>36</sup> Intervistë me Këshilltarin e EULEX-it të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Operacioneve të PK-së / zëvendës shefit të Njësisë këshilluese të Policisë dhe çështjeve kufitare, mbajtur në Prishtinë më 7 korrik 2016.

## 4.6 Studimet e rasteve

Kompleksiteti i raportimit mbi një incident dhe përcjelljes së rrjedhës së procedimit të një incidenti do të ilustruhet përmes një rasti studimor të një incidenti të goditjes me thikë që ka ndodhur më 4 maj 2015 në fshatin Pasjan. ECMI Kosova ka raportuar për këtë incident në vitin 2015 dhe ky raport do të ndjekë rezultatet e procedurës penale, duke përfshirë rezultatet e PK-së, prokurorisë, gjyqësorit dhe dosjeve mjekësore.

Menjëherë pas incidentit, PK-ja u thirr të dalë në vendin e ngjarjes dhe prandaj ishin instanca e parë përgjegjëse. Zyrtarët përgjegjës policor nisën hetimet dhe njoftuan prokurorin kujdestar. PK-ja e ka klasifikuar incidentin si tentim vrasje dhe ka paraqitur edhe një raport për incidentin dhe një raport të shpejtë marrë parasysht që vepra ishte kategorizuar si një vepër e rëndë penale. Në asnjë prej këtyre raporteve PK-ja nuk shfaq apo tregon se ka pasur ndonjë dyshim për motivim etnik në këtë incident.<sup>37</sup>

Në aktakuzën e saj, Prokuroria Themelore në Gjilan ka ndryshuar klasifikimin e krimit dhe ka argumentuar se i pandehuri duhet të ngarkohet me aktakuzën për kryerjen e veprës lëndim i lehtë trupor. Aktakuza po ashtu i referohet, në mënyrë të qartë, një deklaratë të viktimës, ku ai deklaron se ky incident nuk kishte të bënte me konflikt etnik, por incidenti ka ndodhur për shkak se i pandehuri është një person i dhunshëm.<sup>38</sup> Aktakuza nuk ofron, për më tepër, hollësira mbi mundësinë e një motivi paragjykses të këtij sulmi prandaj, as PK-ja dhe as prokurori i shtetit nuk shfaqin asnjë dyshim se vepra penale është kryer me motivim paragjykses.

Në fund, Gjykata kompetente konstatoi se i pandehuri është fajtor për shkaktimin e lëndimit të lehtë trupor ndaj viktimës, dhe i shqiptoi të pandehurit dënimin gjashtë muaj me kusht.<sup>39</sup> Prandaj, Gjykata nuk ka përfshirë nenin 147 dhe nuk ka marrë parasysht karakterin ndëretnike të incidentit si një rrethanë rënduese.

Kur shqyrtohen procedimet e këtij rasti, mos-referimi i Gjykatës nenit 147 është i saktë. Shumë incidente, megjithatë, mes njerëzve që i përkasin etnive të ndryshme, janë kryer me motive të tjera. Si e tillë, është krejtësisht e drejtë të supozojmë se vjedhja nuk ka motivim paragjykses, por është e motivuar mbi të gjitha nga dobia pasurore e kryerësit. Kjo është gjykimi më i mundshëm i një rasti të vjedhjes përderisa nuk ka një dëshmi që tregon se ekziston një motivim paragjykses. Megjithatë, kur dëshmitë për një incident të vjedhjes tregojnë qartë për një motivim paragjykses, neni 74 (2.12) bëhet relevant. Për shkak se ky motivim i mundshëm, dytësor apo i shumëfishtë, në bazë të përkatësisë etnike nuk do të sigurojë që autorët e krimit duhet të dënohen sipas nenit 147, për shkak të fushëveprimit të kufizuar të këtij neni. Kryesi, megjithatë, duhet të dënohet sipas nenit përkatës të KP, së bashku me nenin 74 (2.12) për arsye të rrethanave rënduese për shkak të motivimit paragjykses.<sup>40</sup>

<sup>37</sup> Numri i lëndës 044-2015 i Policisë së Kosovës. Lexuar më 9 qershor 2016 në zyrën e Prokurorit të Shtetit në Prishtinë.

<sup>38</sup> Aktakuzë nga Zyra e Prokurorisë Themelore në Gjilan, numri i dokumentit, PP.II.nr. 992/2015, 19 qershor, 2015.

<sup>39</sup> Gjyqtari dënoi të pandehurin sipas nenit 188, paragrafi 2 dhe nën-paragrafi 1.1 të Kodit Penal, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P. Nr. 620/2015, 8 dhjetor, 2015.

<sup>40</sup> Shih veçanërisht paragrafin e parë të nenit 147 i cili ofron një interpretim të ngushtë të krimeve të urrejtjes në të cilin thuhet: "Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo ndonjë grupi tjetër që jetojnë në Republikën e Kosovës në një mënyrë që mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet."

Për të ilustruar këtë pikë, një rast tjetër, për të cilin ECMI Kosova ka raportuar në maj të vitit 2015, është shqyrtuar dhe janë ndjekur dt[ gjitha fazat e procedurave gjyqësore. ECMI Kosova ka publikuar një raport për një numër të incidenteve të sigurisë që po ndodhnin në rajonin e komunës së Klinës, në maj të vitit 2015, ku viktimat e sulmeve dhe plaçkitjeve ishin një numër, jo i vogël, i banorëve të disa fshatrave të kësaj komune, pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, që ishin kthyer kohët e fundit në shtëpitë e tyre.<sup>41</sup> Këto incidente janë raportuar në Policinë e Kosovës, këta të fundit kanë kryer hetimet dhe kanë arrestuar autorët e këtyre krimeve. Njëri nga disa incidentet ka përfshirë tre shqiptarë të Kosovës të cilët kishin grabitur dhe sulmuar dy familje të cilat ishin familje serbe të kthyer kohët e fundit. Të tre të pandehurit ishin akuzuar dhe procedura gjyqësore ishte mbajtur më 20 janar të vitit 2016,<sup>42</sup> Me ç'rast të pandehurit u gjetën fajtorë për dy vepra penale, përkatësisht vjedhje pas nenit 239, paragrafi 1, së bashku me paragrafin 4, të nenit 239. Në mënyrë të ngjashme, sikur në rastin tjetër që kishte ndodhur në Pasjan, Gjykata Themelore në Pejë nuk ka përfshirë dhe/ apo marrë për bazë nenin 147 dhe as nenin 74 (2.12), në aktgjykimin e saj.<sup>43</sup>

Pa i njohur detajet në rastin konkret, me sa duket është korrekte të argumentohet se motivi kryesor, ndoshta, ishte përfitimi ekonomik i të pandehurve, megjithatë, për shkak se dy familjet ishin familje të të kthyerve serbë, sugjeron se ata janë zgjedhur si viktimat për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Një rast i tillë duhet ndoshta të procedohet si një rast me motive të shumta, dhe nëse janë ofruar provat e nevojshme, autorët duhet të dënohen për grabitje, sipas nenit 239 të KP së bashku me nenin 72 (2.12). Një rast si ky, gjithashtu duhet të përfshihet në statistikat mbi IPEM-ët të regjistruara në institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës, duke përfshirë statistikat e policisë dhe gjyqësorit, për të treguar një pasqyrë më realiste të gjendjes aktuale të tensioneve ndëretnike në Kosovë.

#### **4.7 Mungesa e besimit dhe njohurive të qytetarëve për sa i përket mekanizmave të drejtësisë**

Mungesa e besimit dhe komunikimit mes policisë dhe pjesëtarëve të komunitetit është një tjetër pengesë gjithandej e pranishme për sa i përket raportimit të duhur të incidenteve. Pjesëtarët e komuniteteve hezitojnë, pothuajse rregullisht, të raportojnë incidentet për shkak se ata nuk kanë besim se kjo do të çojë në hetimin e duhur të policisë dhe prokurorisë së shtetit. Ky fakt mund të jetë i lidhur me procedurat e raportimit të zbatuara nga PK-ja, e cila, sipas perceptimit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, nuk e njeh frikën dhe shqetësimet e tyre si komunitete pakica.

Në përgjithësi, Policia e Kosovës është në mesin e institucioneve më të besueshme për sa i përket çështjeve të sigurisë në Kosovë. Në një studim mbi perceptimet e përgjithshme të publikut për institucionet e sigurisë së Kosovës, PK-ja doli të jetë si institucioni i tretë më i besueshëm i sigurisë, i paraprirë nga Forca e Sigurisë së Kosovës dhe KFOR-i.<sup>44</sup> Në mënyrë të veçantë, përqindja e të anketuarëve të për besueshmërinë ndaj këtij institucioni u rrit me 10 përqind (%) krahasuar me vitin e mëparshëm të të njëjtit studim.<sup>45</sup>

<sup>41</sup> ECMI KOSOVA. 'Mbi incidentet e fundit të sigurisë në komunën e Klinës dhe procesin e vështirë të kthimit' (21 maj 2015).

<sup>42</sup> Numri i dosjes së lëndës në Prokurori PP/I Nr. 133/15.

<sup>43</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P. 173/15 (20 janar 2016)

<sup>44</sup> QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË. Barometri Kosovari i Sigurisë, Edicion i pestë (dhjetor 2015), fq.10.

<sup>45</sup> Ibid., fq.8.

PK-ja ishte institucioni i cili kishte qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me shumicën e të anketuarve të studimit, përkatësisht 58 për qind.<sup>46</sup> I njëjti studim, gjithashtu, ka bërë të ditur se perceptimi publik dhe besueshmëria për institucionet e drejtësisë është e ulët, ku 40 për qind (%) të të anketuarve nuk i besojnë prokurorisë së shtetit dhe 51 për qind (5) nuk i besojnë gjykatave.<sup>47</sup>

Një nga mekanizmat që është themeluar për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit mbi mekanizmat e drejtësisë dhe rrugët e komunikimit në mes të pjesëtarëve të komuniteteve lokale dhe policisë janë Këshillat Komunale për Siguri (KKSB-të).<sup>48</sup> Pjesëmarrësit në këto takime, që mbahen të paktën gjashtë herë në vit, përfshijnë një gamë të organizatave dhe individëve, duke përfshirë, por jo kufizuar vetëm në, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës, Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së), mediat, politikanët lokalë, drejtorët e arsimit, etj.<sup>49</sup> Në takimet e KKSB-ve, anëtarët e Këshillit kenë mundësinë që të paraqesin ndonjë ankesë, shqetësim, koment, sugjerim që ata mund të kenë në lidhje me sigurinë në bashkësi. KKSB-të mund të luajnë një rol thelbësor në rritjen e besimit të pjesëtarëve të komuniteteve marrë parasysh që KKSB-ja është një mekanizëm, që së bashku me PK-në, i reagimit të shpejtë dhe efektiv ndaj incidenteve që mund të jenë etnikisht të motivuara dhe të ndjekin procedurat e mëtejme gjyqësore të incidenteve eventuale, duke realizuar të drejtat e viktimave dhe të pjesëtarëve të komuniteteve për drejtësi, siguri dhe mospërsëritje të incidenteve etnikisht të motivuara.

Përveç këtyre takimeve, secila komunë që merr pjesë<sup>50</sup> në këtë program gjithashtu ka të krijuar Ekipin Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSB) i cili përbëhet prej zyrtarëve komunalë, zyrtarëve të Policisë së Kosovës dhe përfaqësuesve lokalë. KKSB-së gjithashtu i kërkohet që të ketë një përfaqësues të EVSB-së në cilësinë e anëtarit të këshillit për të marrë pjesë në mbledhjet e detyrueshme. EVSB-të bashkëpunojnë me PK-në dhe veprojnë në bazë vullnetar ngjashëm me programin amerikan të vëzhgimit të lagjeve nga vetë banorët. Qëllimi kryesor i EVSB-ve është të bashkëpunojnë për të identifikuar dhe adresuar çështjet e krimit, sigurisë dhe përgjegjësisë.<sup>51</sup> For Për përparimin e mëtejme në këtë program është e nevojshme të zhvillohet ideja e vullnetarizmit në lidhje me sigurinë në komunitet dhe të angazhohen anëtarë të tjerë të komunitetit nëpërmjet trajnimit të EVSB-ve.

Dy mekanizma, i KKSB-ve dhe i EVSB-ve janë dy qasje të vlefshme për të adresuar çështjet e nivelit të ulët të raportimit të krimeve si dhe çështjen e perceptimit të viktimave dhe pjesëtarëve të komuniteteve për IPem-ët. Nëse komuniteti ka besim të plotë në aftësitë dhe zotësinë e policisë për të raportuar në mënyrë të duhur mbi IPem-ët sigurisht se do të ndikojë që më shumë viktima do të jenë shumë më të prirë për t'i raportuar krimet që janë kryer ndaj tyre.

---

<sup>46</sup> Ibid., fq.10.

<sup>47</sup> Ibid., fq.12.

<sup>48</sup> KKSB-ja është një "Organ këshillues i kryesuar nga Kryetari i komunës dhe me një anëtarësi që përfaqëson të gjitha komunitetet që jetojnë në komunë." Qëllimi dhe mandati i tij është "të zhvillojë vetëdijen lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, për të identifikuar shqetësimet në lidhje me sigurinë publike dhe sigurinë në përgjithësi dhe të rekomandojë planet e veprimit, për t'i adresuar këto shqetësime nëpërmjet përpjekjeve bashkëpunuese të autoriteteve komunale, pjesëtarëve të komuniteteve lokale dhe policisë". Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë (2 mars, 2012), neni 7.

<sup>49</sup> REPUBLIKA E KOSOVËS, MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, 'Udhëzimi Administrativ 27/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (mars 2012), neni 4, 11(2).

<sup>50</sup> Që nga maji 2016, 34 komuna kanë themeluar KKSB-të. Katër komuna që akoma nuk i kanë formuar këshillat janë ato në veri të Kosovës, përkatësisht Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut. Këto katër komuna, megjithatë, janë në proces të krijimit të këtyre këshillave. Informacion i marrë në një intervistë me Këshilltare në ICITAP në Prishtinë më 16 maj 2016.

<sup>51</sup> Udhëzimi Administrativ 27/2012 MPB, nenet 2(1.10) dhe 17(2).

## 5. RAPORTIMI I MEDIAVE DHE DEGËZIMET/PASOJAT POLITIKE

Raportet e medias, si të atyre kosovare ashtu edhe të atyre serbe, kanë një efekt të thellë në perceptimin e popullatës së përgjithshme për sa i përket incidenteve ndëretnike. Mbulimi medial në Kosovë është ende në masë të madhe i polarizuar etnikisht. Mediat janë shpesh të njëanshme dhe rrallë arrijnë komunitetet e tjera përveç komunitetit që ajo media i drejtohet. Polarizimi është i qartë duke qenë që komuniteti shqiptar i Kosovës ka tendencë për të parë kryesisht mediat e Kosovës, ndërsa burimi kryesor i informacionit të komunitetit serb të Kosovës është media e Beogradit.<sup>52</sup> Raportimi është gjithashtu i polarizuar në kuptimin që zakonisht është i kufizuar në burimet e gazetarëve brenda komunitetit përkatës të gazetarit/es, të cilat shpesh rezultojnë në raporte të njëanshme dhe jo të plota. Raportet, mbi incidentet ndëretnike në veçanti, shpesh bazohen në burime të vetëm një komuniteti, duke i bërë shumë nga ato raporte të pabazuara. OSBE-ja nëpërmjet monitorimit të saj ka identifikuar se mediat kanë tendencë t'i bëjnë referencë etnisë së autorëve të dyshuar të krimeve, edhe kur një incident nuk ka treguar me anë të ndonjë treguesi se është kryer me motivacion etnik apo politik.<sup>53</sup>

Raportet e mëparshme të ECMI Kosovës gjithashtu identifikojnë tendencën e serbëve të Kosovës dhe medieve serbe që shpejt-e-shpejt të deklarojnë se incidentet kanë qenë etnikisht të motivuara. Duke mos marrë kurrfarë përgjegjësie, për të raportuar në mënyrë objektive dhe shumëdimensional për këto incidente, raportimi i këtyre medieve rrezikon të nxisë një shpërthim të mundshëm të tensioneve etnike gjithandej në Kosovë. Siç e kemi parë në trazirat e marsit 2004, nëpërmjet raportimit sensacional dhe të njëanshëm, një incident i vetëm mund të ketë efekt të gjerë dhe të ndikojë në një shpërthim të dhunës me motive etnike. Kjo nuk do të thotë se media duhet të përmbahen nga, ose të minimizojë raportimin mbi motivin e mundshëm etnik të një IPEM-i. Por, edhe media në gjuhën shqipe edhe ajo në gjuhën serbe kanë nevojë që të përmirësojnë raportimin dhe të përpiqen të përfshijnë në raportimin e tyre burime dhe këndvështrime nga komunitete të ndryshme dhe zëra nga sfera politike dhe publike në mënyrë që të ofrojnë lajmë që kanë vërtetësi, objektivitet dhe besueshmëri.

Në mënyrë të ngjashme, politikanët janë shpesh të prirë që në një mënyrë të shpejtë të politizojnë incidentet ndëretnike.<sup>54</sup> Në raportimin për incidentin sulmit në Pasjan, media në gjuhën serbe kanë bazuar raportimin e tyre në deklaratat që kishin bërë përfaqësuesit politikë të serbëve të Kosovës. Ata kishin cituar Kryetarin e Parteshit, Dragan Nikolić, që kishte thënë se "sulmi ka pasur për qëllim ngacmimin dhe dëbimin e serbëve që kanë mbetur në këtë pjesë të Kosovës."<sup>55</sup> Duke pasur parasysh natyrën e incidentit në Pasjan dhe pasigurinë për një motivim paragykues, gjykimi i ngutshëm dhe përkufizimi i menjëhershëm i këtij incidenti si i motivuar etnikisht i bërë nga Nikolić duket si gjykim impulsiv dhe i pabazuar.

<sup>52</sup> BUREMA, Lars. 'Procesi i pajtimit në Kosovë: disa hapa të ndërmarrë, një rrugë e gjatë përpara', Revisa për politika etnike dhe çështje të komuniteteve në Evropë (2012/4), fq. 7–27. fq. 20.

<sup>53</sup> Misioni I OSBE-së në Kosovë: Raporti I vlerësimit të drejtave të komuniteteve, Edicioni I katërt, fq.34.

<sup>54</sup> ECMI Kosova. 'Incidente dhe tension në Mitrovicë: Nevoja për një Raportim të paanashëm dhe forcim të sundimit të ligjit' (21 prill, 2015).

<sup>55</sup> KOSSEV, 'Është therrur një qytetar serb në Pasjan' (4 maj 2015). Originali në gjuhën serbe: "Napadzacijimauznemiravanje I proterivanjepreostalihSrbaizovogdelaKosova"

Ndërsa, politikanët serbë të Kosovës janë të vetëdijshëm për ndjeshmërinë e IPEM-ve në Kosovë dhe shpesh bëjnë deklaratat të balancuara duke i referuar ato tek institucionet e sundimit të ligjit, politikanët në Serbi janë, posaçërisht, të shpejtë për të klasifikuar një incident si ndëretnik, kurdo që komentojnë IPEM-ët në Kosovë, në mënyrë që ta bëjnë të fortë argumentin e tyre, se është e nevojshme mbështetja e vazhdueshme nga Serbia për të garantuar sigurinë e komunitetit serb të Kosovës.<sup>56</sup>

Deklarata të tilla janë dhënë në mënyrë të rregullt nga mediat në gjuhën serbe, gjë kjo që dërgon tek interpretimi krejtësisht i njëanshëm për sa i përket IPEM-ve, interpretime këto që janë shumë komplekse. Rrjedhimisht, mediat, politikanët dhe figurat e tjera publike kanë një përgjegjësi të përbashkët për të raportuar në mënyrë objektive dhe për të mos keqpërdorë këto incidente për agjendën e tyre politike. Për këtë arsye është e rëndësishme që politikanët nga të dyja etnitë të marrin përgjegjësinë për deklaratat e tyre, të përmbahen nga deklarimi dhe dhënia e supozimeve të nxituara mbi motivet pas një incidenti dhe të deklarojnë besimin e tyre ndaj policisë dhe prokurorisë së shtetit për të hetuar dhe analizuar rastin/et. Në qoftë se këtyre incidenteve u qaset në mënyrë korrekte nga politikanët dhe media, ata (politikanët dhe media) mund të ofrojnë një ndjenjë të sigurisë për qytetarët e prekur dhe të krijojnë një kulturë të sundimit të ligjit, që është qenësore për trajtimin e incidenteve ndëretnike në Kosovë.

---

<sup>56</sup> ECMI Kosova, 'Mbi incidentet e fundit të sigurisë në Komunën e Klinës dhe procesin e vështirë të kthimit' (21 maj, 2015).

## 6. VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Ky raport është hartuar për të siguruar një pasqyrë të plotë për sfidat që ekzistojnë si brenda kuadrit ligjor, mbledhjes së të dhënave dhe raportimit të medieve për incidentet ndëretnike në Kosovë.

Mund të konstatohet se numri i rasteve të regjistruara të IPEM-ve në PK, Prokurorinë e shtetit dhe në Gjyqësor nuk është në përputhje me incidentet ndëretnike dhe me perceptimin e popullsisë për këto incidenteve. Integrimi i dobët është një faktor që mund të shpjegojë këtë mospërputhje. Me fjalë të tjera, organet e lartpërmendura kanë regjistruar më pak incidente se sa që është menduar se ekzistojnë, sepse serbët dhe shqiptarët jetojnë shumë të ndarë.

Së dyti, dhe ndoshta më e rëndësishmja, mënyra në të cilën PK, Prokuroria e shtetit dhe Gjyqësori klasifikojnë incidentet dhe mbajnë statistikën, sugjeron se ne, të interesuarit, nuk po shohim një pasqyrë të tërë të krimeve ndëretnike në Kosovë. Siç është shpjeguar, forma standarde e raportimit që përdorë PK-ja nuk lejon mundësinë e përshkrimit të motivit etnik të një incidenti. Në përputhje me ndjeshmërinë politike të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, PK-ja ka tendencë të nën-raportojë motivet e mundshme etnike, marrë parasysh faktin që nuk është lënë mundësia e përshkrimit të motivit të një incidenti në formën standarde të raportimit. Përveç kësaj, të dhënat statistikore nuk janë të koordinuara ose integruara në tre nivelet institucionale për procedurë penale, që pengon analizën e saktë të të dhënave statistikore mbi IPEM-ët për krijimin e politikave dhe procesin e vendimmarrjes. Masat e vazhdueshme për reforma për të krijuar një sistem uniform të përcjelljes së të dhënave për të gjitha institucionet e përfshira do të sillnin një bazë të nevojshme për analiza të sakta statistikore, por kërkesa për të dhëna të njëjta (të dhëna uniforme) në të gjitha nivelet institucionale mund të ketë efekt të padëshirueshëm, duke maskuar hollësitë apo mprehtësinë e statistikave në vend se të unifikojë atë.

Korniza aktuale ligjore, më në fund, është adekuate për të trajtuar incidentet ndëretnike, por nuk është shfrytëzuar në bazë të qëllimit që ka. Neni 147 nuk mbulon, në mënyrë adekuate, motivimin paragykyes dhe neni 74 (2.12), për këtë arsye, është një mjet i rëndësishëm ligjor. Deri më sot, neni 74 (2.12) ende nuk është i referuar në asnjë prej vendimeve të marra nga gjykatat. Prokuroria dhe Gjyqësori do të duhet të fillojë të zbatojnë nenin 74 (2.12) për të adresuar në mënyrë efektive veprat e kryera ndëretnike.



## 7. REKOMANDIMET

Në shqyrtimin e procesit aktual të raportimit të incidenteve konstatojmë që ekzistojnë disa përmirësime për të cilat ne rekomandojmë që të zbatohen në të gjitha fazat e ndryshme të procesit të raportimit të incidentit - nga policia tek institucioni i gjyqësorit.

### 7.1 Përkufizimi dhe Raportimi

Futja në përdorim e një mekanizmi të sinjalizimit dhe normalizimi i IPEM-ve:

- Për të futur një mekanizëm që i lejon policisë të sinjalizojë një rast, në qoftë se viktima e përfshirë në atë rast e percepton se incidenti ishte i motivuar nga paragjykimi ndaj tij/saj. Sinjalizimi i një rasti do tu tregonte hetuesve, të cilët mbledhin prova, për mundësinë e motivimit etnike pas një incidenti, por nuk do të përcaktonte klasifikimin përfundimtar të incidentit si i motivuar etnikisht. Klasifikimi përfundimtar i incidentit është përgjegjësi e gjykatës kompetente, dhe mbështetet në rastin siç të referuar nga Prokurori. IPEM-ët në vetvete nuk janë të jashtëzakonshme, por që motivi etnik duhet të vihet në perspektivë apo në spikamë. Kjo vlen edhe për prirjen e politikanëve serbë për të ekzagjeruar komponentin etnik në një incident, edhe për zyrtarët e PK-së dhe politikanët e Kosovës, të cilët minimizojnë çdo element apo motiv etnik në një rast, madje edhe në rastet kur mund të ekzistojnë motive themelore etnike dhe se incidenti mund të perceptohet si i tillë nga njerëzit. PK-ja duhet të fokusohet në elemente të cilat mund të tregonin për motive etnike pas një incidenti dhe të marrë në konsideratë perceptimin e njerëzve apo motivet themelore etnike. Sinjalizimi i rasteve, për këtë arsye, duhet të futet në përdorim si një teknikë për të hequr stigmën dhe frikën e pasojave politike.

### 7.2 Rritja e mbledhjes, analizimit dhe shpërndarjes së të dhënave

Meqë proceset e raportimit të incidenteve vijnë duke u përmirësuar, do të jetë, gjithashtu, shumë e rëndësishme që të vendoset përqendrim më i madh në analizimin statistikor të krimeve etnikisht të motivuara për të identifikuar vendet dhe grupet kryesore problematike si bazë për proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse. Që kjo të bëhet e mundur, ne sugjerojmë si më poshtë:

- Kompletimi i një baze kryesore, ndër-departmentesh, të të dhënave për sistemin e menaxhimit të rasteve duhet të finalizohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Një pengesë e madhe në mbledhjen adekuate të të dhënave dhe analizimit të duhur është mungesa aktuale e një sistemi i cili mund të shpërndajë informacionin në mes të PK-së, Prokurorisë dhe Gjyqësorit;
- Të sigurohet që të gjithë zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe të gjitha stacionet policore në çdo komunë të Kosovës u nënshtrohen trajnimeve të duhura dhe pajisjeve adekuate për menaxhimin, përditësimin dhe shfrytëzimin e duhur të sistemit të ri të menaxhimit të rasteve/lëndëve sipas qëllimit të synuar;
- Raportimi i policisë mbi motivet e mundshme etnike dhe komponenti ndëretnik (shih 4.2) duhet të formojnë bazën për informacione statistikore, më kuptimplotë, në komponentin etnik në incidentet kriminale, e cila duhet të merret parasysh në proceset e politikbërëse dhe vendimmarrëse. Vendimi PK-së për të mos mbajtur dhe evidentuar statistikë nga viti 2016 duhet të rishikohet, pasi që informacioni kyç është humbur kur statistikat mbahen dhe paraqiten vetëm nga Prokuroria.

Në vend të përpjekjeve për bashkimin të dhënave statistikore, të tre institucionet duhet të rrisin bashkëpunimin dhe të zbatojnë trajnime të përbashkëta për të arritur një konsensus dhe një qasje të përbashkët për klasifikimin e këtyre incidenteve. Përveç kësaj, PK-ja duhet të mbajë statistika për të gjitha incidentet e regjistruara ndëretnike, dhe jo vetëm të ruaj ato statistika ku prokuroria ka autorizuar hetimet.

### 7.3 Ndjekja penale dhe gjykimi i IPEM-ve

- Duhet të vendoset një fokus i përgjithshëm, më i madh, në nenin 74 (2.12) në ndjekjen e IPEM-ve. Edhe pse ky nen është një dispozitë e përgjithshme e Kodit Penal, dhe jo një vepër penale, është ende një mjet i rëndësishëm ligjor për të trajtuar siç duhet dhe për të dënuar incidentet me motive të shumta. Prandaj, Gjykatat duhet të shfrytëzojnë potencialin e plotë të këtij neni për të trajtuar krimet që bien jashtë fushëveprimit dhe objektit të nenit 147, por që megjithatë janë të kryera me një motivim paragjykes.
- Gjyqësori duhet të fillojë të mbledhë statistika kur neni 74 (2.12) është përdorur si bazë ligjore për të rritur masën e dënimit.

### 7.4 Forcimi i lidhjeve me pjesëtarët e komuniteteve

Për të trajtuar në mënyrë adekuate dhe për të kuptuar viktimën dhe perceptimin e komunitetit, është e nevojshme që të promovohet një ambient në të cilin pjesëtarët e komunitetit, përkatës, pakicë ndjehen komfort për të raportuar incidentet që atyre mund tu ndodhin. Është e rëndësishme që njerëzit të ndjehen të sigurt në aftësinë e policisë për të adresuar si duhet incidentet dhe për të ulur frikën, sidomos, tek pjesëtarët e komuniteteve pakicë. Përpjekjet ekzistuese për të forcuar lidhjet ndërmjet PK-së dhe pjesëtarëve të komuniteteve mund tu ndihmojnë të gjitha palëve relevante për të kuptuar shqetësimet e njëri-tjetrit.

Lidhjet apo një marrëdhënie më e fortë me pjesëtarët e komuniteteve mund t'i ndihmojë PK-së që të qetësojë situatat në lidhje me kategorizimet e pasakta ose të nxituara të incidenteve si fillimisht etnikisht të motivuara, por në të njëjtën kohë të marrë parasysh potencialin ose praninë themelore të elementeve etnikë dhe perceptimet e palëve të përfshira.

- KKSBB-të duhet të vendosen në të gjitha komunat e Kosovës, edhe në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës.

## 8. REFERENCAT

### AKTET LIGJORE

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082 20 prill, 2012  
Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-123, 13 dhjetor, 2012.  
Ligji për Policinë, Ligji Nr. 04/L-076, 2 mars, 2012.  
Udhëzimi Administrativ 27/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (mars 2012).

### RAPORTET

BUREMA, Lars. Pajtimi në Kosovë: “Disa hapa të ndërmarrë, një Rugë e gjatë përpara”. Revista për Politika etnike dhe Çështje të Pakicave në Evropë(2012/4), f 7-27.  
ECMI KOSOVA. “Incidentet dhe tensionet në Mitrovicë: Nevoja për një raportim të paanshëm dhe forcim të sundimit të ligjit” (21 prill, 2015).  
ECMI Kosova. ‘Me rastin e incidentit të fundit në Pasjan’ (10 maj, 2015).  
ECMI Kosova. ‘Mbi incidentet e fundit të sigurisë në komunën e Klinës dhe procesin e vështirë të Kthimit’(21 maj, 2015).  
EULEX. RAPORTI I PROGRESIT PËR MARRËVESHJEN KOMPAKTE(shtator, 2015).  
KOMISIONI EVROPIAN. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2015 (2016).  
KOMISIONI EVROPIAN. Raporti i Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, raporti i tretë për progresin e arritur të Kosovës në kërkesat e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave(COM (2015) 906, 18 dhjetor, 2015).  
KOMISIONI EVROPIAN. Raporti i Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin për raportin e dytë për progresin e Kosovës në përmbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave(COM (2014) 488, 24 July 2014).  
Qendra Kosovare për Çështje të Sigurisë. Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i Pestë(dhjetor, 2015).  
OSBE/ODIHR. Ligjet e krimit të urrejtjes - një udhëzues praktik(2009).  
Misioni I OSBE -së në Kosovë Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve ... Raporti i katërt,(nëntor, 2015).  
KËSHILLI I SIGURIMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA. ‘Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë’, (Dokumenti S/2015/74, 30 janar, 2015).

### ARTIKUJ TË GAZETAVE DHE PORTALEVE

B92. ‘Të dënohen ata që sulmuan’(5 maj, 2015).  
KOSSEV, ‘Është goditur me thikë një serb në Pasjan’(4 maj, 2015).

### INTERVISTA

Drejtorin e Departamentit të Statistikave, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Zyra e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 12 maj, 2016.  
Njërin nga këshilltarët e ICITAP-it, Prishtinë, 16 maj, 2016.  
Udhëheqësin e departamentit për çështje ligjore, Policia e Kosovës, në shtabin qendror të Policisë së Kosovës në Prishtinë, 17 maj, 2016.  
Koordinatorin për krime të urrejtjes ndëretnike, Zyra e Prokurorit të Shtetit, Zyra e Prokurorit të

Shtetit në Prishtinë, 24 maj, 2016 dhe 9 qershor, 2016.

Zyrtarin e lartë të OSBE-së, Sektori për Komunitete në kuadër të Departamentit për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete, Zyra e OSBE-së në Prishtinë, 6 korrik, 2016.

Këshilltarin e EULEX-it të Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Operacioneve të PK-së/ Zëvendës shefi i Njesisë Këshilluese të Policisë dhe çështjeve kufitare, Prishtinë 7 korrik, 2016.





Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë